



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201131/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Reç, Shkodër.*

Drejtuar: **Z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Erion LASKA
Drejtor i IEVP-së Reç, Malësi e Madhe

SHKODËR

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenet 19/1 dhe 30/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenin 81 të ligjit 81/2020 "Për trajtimin e të drejtave të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim periodik në datë 14.09.2022 në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Reç, Shkodër, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i inspektimit në IEVP Reç ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të burgosurve në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve; garantimi i sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimi i kushteve për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre; kontrolli dhe administrimi i

dokumentacionit ku evidentohet puna e kryer sipas sektorëve; si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm¹.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, ka të drejtën e detyrimit ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi dhe të adresojë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, grupi i inspektimit zhvilloi një takim informues me drejtorin e institucionit z.Erion Laska dhe shefin e policisë z.Nikolin Gjonpalaj, të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit.

Në takim drejtuesit e institucionit na informuan në lidhje me gjendjen e kushteve të jetesës për të burgosurit, ambientet e përbashkëta funksionale dhe aktivitetet që zhvillohen sipas grupmohave me të burgosurit në institucion, masat e marra për trajtimin psiko-social dhe trajtimin shëndetësor të të burgosurve nga sektorët përgjegjës, si dhe për nivelin e realizimit të rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i mëparshëm.

Sipas informacionit, IEVP Reç, bazuar në Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë *“Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”*, kategorizohet *“Burg i sigurisë së zakonshme”* me një seksion për të dënuarit, një seksion për të paraburgosurit dhe një seksion i kujdesit të veçantë (SKV).

Në ditën e inspektimit, në IEVP Reç ishin akomoduar 603 të burgosur, nga të cilët 366 të dënuar dhe 228 të paraburgosur. Kapaciteti zyrtar i institucionit ishte për 781 persona, referuar numrit të dhomave për banim dhe numrit të shtretërve. Institucioni kishte ambiente për akomodim të të burgosurve edhe në sektorin e infermierisë, SKV-në, si dhe sektorin e observimit e veçimit, duke shtuar kapacitetin e tij në një numër prej 850 persona. Por, këto ambiente janë për qëndrim të përkohshëm dhe nuk duhet të llogariten për efekt të kapacitetit zyrtar. Në lidhje me përcaktimin e kapacitetit zyrtar, institucioni **nuk** kishte një urdhër për miratimin e tij nga organi epror DPB-ja, situatë e njejtë edhe për institucionet e tjera të sistemit penitenciar.

Gjithashtu, grupi i inspektimit kërkoi informacion për situatën e popullimit edhe për periudhën vjetore të inspektimit, e cila rezultoi si më poshtë vijon:

- Muaj Janar 497 të burgosur (180 të p/b dhe 317 të dënuar)
- Muaj Shkurt 497 të burgosur (173 të p/b dhe 324 të dënuar)
- Muaj Mars 499 të burgosur (164 të p/b dhe 335 të dënuar)
- Muaj Prill 495 të burgosur (171 të p/b dhe 324 të dënuar)
- Muaj Maj 502 të burgosur (173 të p/b dhe 329 të dënuar)
- Muaj Qershor 608 të burgosur (256 të p/b dhe 352 të dënuar)

¹ Shkresë nr.K4/I51-2 prot., datë 24.11.2021 dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

- Muaj Korrik 595 të burgosur (242 të p/b dhe 353 të dënuar)

Sikurse paraqitet nga statistikat e raportuara, në IEVP Reç nuk ka patur situata mbipopullimi për periudhën e inspektimit. MKPT-ja konstatoi se, të paraburgosurit dhe të dënuarit ishin të ndarë më vehte sipas seksioneve në 4 (katër) godinat që ndodheshin në regjimin e brendshëm, në përputhje me Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë.

Struktura organike e IEVP Reç është miratuar me urdhër të Kryeministrit të Shqipërisë në vitin 2020 dhe përbëhej nga 366 punonjës, prej të cilëve 39 punonjës civil dhe 327 stafi policor i burgut. Nga informacioni, rezultoi se institucioni kishte mungesa në plotësimin e organikës. Në stafin policor mungonin 94 punonjës policie, kryesisht punonjës të rolit bazë (PRB). Ndërsa në stafin civil mungonin 2 mjek (një mjek ishte i punësuar me kohë të pjesëshme), 1 jurist, 1 përgjegjës i sektorit i çështjeve shoqërore dhe 1 specialisti psikolog.

Mungesat e konstatuara në organikë, kryesisht të stafit policor (afërsisht 1/3 e numrit të përgjithshëm) dhe mungesa e mjekëve, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, përbëjnë problem shqetësues për garantimin e sigurisë dhe shëndetin e të burgosurve. Ndaj është emergjente që DPB-ja, të përshpejtojë procedurat e rekrutimit të punonjësve civil dhe atij policor, sipas detyrave funksionale, pasi IEVP Reç është burg me kapacitet të madh dhe për menaxhimin e tij, kërkohet që edhe organika të jetë e plotësuar në përputhje me kapacitetin e tij zyrtar.

Përsa i takon nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm², nga monitorimi u konstatua se:

- Ishin nënshkruar kontratat e punësimit, midis institucionit dhe të burgosurve të punësuar, për shpërblimin financiar të punës së kryer, duke filluar nga data 1 korrik 2022.
- Ishte në fazë prokurimi në DPB, vënia në funksionim e sistemit HVAC (chiller, kaldajë) për sigurimin e ngrohje/ftohjen të ambienteve të brendshme të institucionit, si dhe për sigurimin e ngrohjes së ujit sanitar për larjen e të burgosurve, në përshtatje me kushtet klimaterike të zonës.
- Ishte hapur një regjistër i veçantë në sektorin e protokoll-arshivës të institucionit, për regjistrimin e kërkesë/ankesave të të burgosurve, i cili administrohej nga sektori i çështjeve shoqërore.
- Ishte plotësuar organika e sektorit shëndetësor të institucionit me 1 farmacist dhe 2 infermierë, por ende kishte mungesa në mjekë të përgjithshëm me kohë të plotë.

Gjithashtu, u evidentua se disa prej rekomandimeve nuk ishin plotësuar:

- Mungonte organizimi i aktiviteteve të përbashkëta masive midis sektorëve të të burgosurve, të cilat rrisin ndërveprimin me njëri-tjetrin, zhvillimin e kreativitetit, si

² Rekomandimi i AP-së datë.16.11.2021

dhe ndikojnë në forcimin e mardhënieve midis të burgosurve pavarësisht kategorive dhe grupmoshave.

- Ambienti i palestrës nuk ishte i plotësuar me vegla për ushtrimin e forcës dhe nuk ishte bërë funksional, me qëllim që të burgosurit ta shfrytëzonin atë si mundësi për të kaluar kohën e lirë.
- Të burgosurit e moshës 18-21 vjeç, nuk ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë dhe planin e aktiviteteve, për këtë kategori.
- Operatori telefonik që ofron shërbimin e telefonave me kartë në burgje, ende nuk ka mundësuar hapjen e linjës pa shpërblim për numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit dhe komunikimin e të burgosurve me institucionin tonë, për adresimin e ankesave.
- Nuk ka rezultate konkrete nga grupi i punës i ngritur për ndryshimin e Urdhërit të përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.205/3 prot., datë 27.07.2006 “*Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit*”.

Inspektimi i MKPT-së në IEVP Reç, u krye pa paralajmërim dhe pa mbikqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave konfidenciale me të burgosurit, si dhe u zhvillua në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Trajtimi i të burgosurve

Grupi i inspektimit të MKPT-së u informua nga drejtuesit e institucionit, por zhvilloi edhe intervista konfidenciale me të burgosurit, në lidhje me trajtimin e tyre nga stafi i institucionit, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit dhe të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime nga të burgosur për keqtrajtime dhe tejkallim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni.

Grupi i inspektimit, një vëmendje të veçantë i kushtoi kqyrjes së procedurave që ndiqen nga stafi i institucionit për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve nga administrata e institucionit, funksionimit të komisionit të pritjes në lidhje me trajtimin e të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion, funksionimin e komisionit për dhënien e masave disiplinore, cilësisë së aktiviteteve që zhvillohen me të burgosurit, ofrimin të shërbimit dhe trajtimi shëndetësor të të burgosurve, cilësisë dhe larmishmërisë së ushqimit, furnizimit të të burgosurve sipas normativave mujore me detergjente dhe mjete të higjenës personale, etj.

Theksojmë se, infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit ishte e plotë dhe funksionale, e cila mundëson jetesë normale dhe llojshmëri të zhvillimit të aktiviteteve me të burgosurit, sipas kategorive dhe grupmoshave. Godinat, dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta në regjimin e brendshëm, janë në gjendje të mirë teknike.

Sektori i paraburgimit (1 godinë) ishte i ndarë nga sektori për të dënuarit (3 godina), të cilat komunikonin me korridore të brendshme, dhe ishin të vendosur në godina më vehte. Gjithashtu, shërbimet që ofrohen për të burgosurit ishin të organizuara në një godinë tjetër.

Një nga problemet më shqetësuese, që u ngrit në takim nga drejtuesit e institucionit, si dhe intervistat e zhvilluara me të burgosurit, ishte mungesa e mjekut (2 mjek sipas organikës) i punësuar me kohë të plotë, pasi kërkesat e të burgosurve për kryerjen në kohë të vizitave mjeksore, apo dhe për lëshimin e rekomandimeve për vizita mjeksore pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Shkodër, ishin të shumta.

Institucioni aktualisht kishte vetëm një mjek të punësuar me kohë të pjesëshme, i cili e kishte krejtësisht të pamundur për të përballuar kryerjen e vizitave mjeksore në kohë, sipas kërkesave të të burgosurve. Avokati i popullit vlerëson se në pamundësi të punësimit të mjekëve me kohë të plotë IEVP duhet të punësojë dyfishin në numër mjek part-time.

Koha në dispozicion për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku, ishte në varësi të numrit të kërkesave dhe diagnozës që paraqisnin të burgosurit, të cilat varionin brënda ditës ose maksimumi brënda 2 ditëve. Vizitat mjeksore pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal të Shkodrës, me rekomandimin e mjekut të institucionit, kryheshin në varësi të masave të sigurisë për lëvizjen e të sëmurëve nga IEVP për në spital, mundësisht menjëherë për rastet urgjente, ndërsa për të sëmurët kronikë koha e pritjes shkonte deri në 10 ditë.

Të burgosurit kishin gjithashtu pretendime edhe për mungesën e shërbimit shëndetësor në Spitalin Rajonal në Shkodër, pasi kishte raste që vizitat mjekësore nga mjekët specialistë nuk kryheshin në dhomat e mjekëve në ambientet e spitalit, por brenda në automjetin e ambulancës së institucionit.

Njëkohësisht, disa të burgosur të cilët kishin kryer analiza mjekësore në spitalin e Shkodrës, ngritën me shqetësim se nuk kishin marrë asnjë përgjigje në lidhje me rezultatin e analizave, pavarësisht se kishin kaluar 15 ditë deri dhe 1 muaj në raste të veçanta.

Kjo situatë, në vlerësimin e MKPT-së, përbën kufizim të së drejtës themelore të të burgosurve për të marrë shërbim shëndetësor në kohë sa më të shpejtë, si dhe për të marrë shërbim shëndetësor cilësor pranë spitaleve apo klinikave mjeksore, që ndodhen në qytetin e Shkodrës.

Një problematikë tjetër që u evidentua nga intervistat me të burgosurit, kishte të bënte me mungesën e furnizimit me ujë të rrjedhshëm dhe mungesën e ngrohjes të ujit sanitar që shërbente për larjen e të burgosurve.

Të dyja këto shqetësime të ngritura në 4 vitet e fundit nga të burgosurit. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, rrjeti i ujës-jellësit të qytetit të Koplikut furnizohej nga burime uji, të cilat vitet e fundit kishin filluar të shteronin, ndaj kufizimet kishin filluar edhe për popullatën e qytetit. Në këto kushte, furnizimi me ujë i ambienteve

të brendshme kryhej 3 herë në ditë, me orare të reduktuara 2-4 orë, i cili ishte i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat e të burgosurve. Në mungesë të funksionimit të sistemit të chillerave, ngrohja e ujit për larjen e të burgosurve kryhej me kaldajë me naftë, e cila ndizej me orare dhe nuk përballonte kërkesat për larjen e trupit të të burgosurve, sipas parashikimeve në rregulloren e burgjeve 2 herë në javë. Në këtë situatë, të burgosurit përdornin mjete ngrohëse alternative për ngrohjen e ujit dhe larjen e trupit në dhomat e banimit.

Grupi i inspektimit, mori ankesa nga të burgosurit edhe për mosfunksionimin e sistemeve HVAC (chiller, kaldajë), që shërben për ngrohjen/ftohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm. Ky shqetësim bëhej serioz gjatë stinës së dimrit kur temperaturat në këtë zonë ishin të ulta deri nën zero. Institucioni për periudhën e dimrit kishte lejuar futjen në regjimin e brendshëm të ngrohëseve elektrike, ndërsa në verë të pajisjeve elektrike për ftohje, të cilat veç funksionit të tyre, kishin rritur ngarkesat në rrjetin elektrik dhe dëmtonin sistemin e brendshëm elektrik.

Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, riparimi i sistemit të chillerave është në fazë prokurimi nga sektori i logjistikës në DPB dhe mendohet të mbyllet brenda vitit 2022. Në lidhje me këtë shqetësim, IEVP Reç ka dërguar disa informacione DPB³, ku shtrohet nevoja urgjente e vënies në funksionim të këtij sistemi qëndror, në përmbushje të kushteve normale të jetesës e të trajtimit që duhet të krijohen për të burgosurit, të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion.

Në vijim të ankesave, të burgosurit ngritën si shqetësim dhe mungesën e aktiviteteve kulturore dhe sportive me pjesmarrje të gjerë, të cilat vazhdojnë të mungojnë gjatë kësaj periudhe. Të vetmet aktivitete që zhvilloheshin ishte orari i ajrimit dhe lojrat e tavolinës në hollin e çdo sektori, të cilat ishin të pamjaftueshme në arritjen e qëllimit për ruajtjen e shëndetit mendor dhe më tej për rehabilitimin e kësaj kategorie.

Në këtë aspekt, autoritetet e institucionit kanë detyrimin që të organizojnë aktivitete të veçanta me të burgosurit, sipas nevojave që ata kanë. Rregullore Europiane e Burgjeve parashikon që të burgosurve t'u organizohen veprimtari për kalimin e kohës së lirë, ku të përfshihen sportet, lojrat, aktivitetet kulturore, hobet dhe aktivitete të tjera. Gjatë veprimtarive të burgosurit duhet të lejohen të shoqërohen me njëri-tjetrin dhe bashkarisht të organizojnë kohën e lirë⁴.

Nga inspektimi i ambienteve, u konstatua se IEVP Reç ka ambiente bosh të pashfrytëzuara, të cilat mund të kthehen në funksion të aktiviteteve për të burgosurit. Ambienti i parashikuar për palestër është ende i pa plotësuar me pajisje dhe vegla të

³ Shkresë nr.3767 prot., datë 16.11.2021 dhe shkresë nr.466 prot., datë 07.02.2022 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

⁴ Pika 27.6 dhe 27.7 e Rregullores Europiane të Burgjeve.

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>

forcës, ku të burgosurit të mund ta përdornin sipas një grafiku, për ushtrime fizike dhe për kalimin e kohës së lirë.

Të burgosurit ngritën si shqetësim mungesën e prezencës në sektorë të punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore dhe të juristit. Ankesat konsistonin në nevojën që kishin të burgosurit për trajtime psiko-sociale, me qëllim uljen e stresit dhe të ankthit, mungesën e asistencës së stafit në marrjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve, dhënien e ndihmës juridike për çështje që lidhen me veprën penale të kryer nga ana e tyre, si dhe për llogaritjen e kohës së dënimit.

Drejtuesit e institucionit e justifikonin këtë situatë, me mungesat në organikë të punonjësve në sektorin e çështjeve shoqërore dhe sektorin juridik, të cilat vijonin të kishin mungesa. Sipas informacionit, kompletimi me specialistë sipas strukturës organike të miratuara të institucionit, paraqet vështirësi për tu plotësuar pasi zona ku ndodhet IEVP ka mungesë të specialistëve, por dhe për shkak të largësisë së vendodhjes së institucionit. Nga ana e strukturave përgjegjëse duhen marrë masa konkrete për sigurimin e transportit për personelin që punon në këtë institucion.

Grupi i inspektimit, konstatoi se të burgosurit e moshës 18-21 vjeç nuk ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të burgosurit e tjerë. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të burgosurit e tjerë. Ajrimi dhe veprimtaritë me karakter sportiv dhe edukativ, vijonin të zhvilloheshin me grupe të vogla dhe të ndara sipas grup moshave dhe interesave të të burgosurve.

IEVP Reç kishte një sektor paraburgimi, ku një pjesë e të burgosurve, kishin çështje për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ata ngrinin shqetësimin se, për çdo seancë gjyqësore, të paraburgosurit shoqërohen dhe qëndrojnë deri në 7 ditë në ambientet e observimit të IEVP-së Shënkoll, deri në përfundimin e seancës gjyqësore. Ata pretendojnë se, në këto ambiente mungojnë kushtet higjieno sanitare dhe të paraburgosurve nuk ju plotësojnë as kushtet minimale për trajtimin ushqimor, larjen e trupit, komunikimin me telefon me familjarët e tyre, etj. Kjo problematikë konsiderohet mjaft shqetësuese dhe megjithëse koha është e shkurtër kësaj kategorie duhet ti sigurohet trajtim me dinjitet dhe plotësim të nevojave jetike bazike edhe për këtë periudhë tranzitore.

Një problematikë që u evidentua nga intervistat me të paraburgosurit, kishte të bënte edhe me zvarritjet në zbardhjen e vendimeve nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe ekzekutimin në kohë të tyre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga verifikimi i disa ankesave të të burgosurve, rezultoi se zvarritja e vendimeve shkonte nga 6 muaj deri në 1.5 vjet. Ky konstatim ka të bëjë me procedurat gjyqësore dhe të prokurorisë, por edhe administrata e IEVP-së duhet të bashkëpunojë më shumë dhe të jetë proaktive me administratat respektive, pasi është e pajustificuar një zvarritje kaq e gjatë e zbardhjes së vendimeve gjyqësore.

Në lidhje me trajtimin ushqimor, të burgosurit nuk paraqitën ankesa, por ata ngritën problemin e ndryshimit të normës (kuotës) ushqimore ditore, e cila nuk ka ndryshuar që nga viti 2006. Avokati i Popullit nëpërmjet MKPT-së ka disa vite që rekomandon ndryshimin e urdhërit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.205/3 prot., datë 27.07.2006 “*Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit*”, por ky rekomandim ende nuk ka gjetur zbatim. DPB-ja nga ana saj, ka dërguar informacion ku thuhet se, është ngritur grupi i përbashkët i punës me ministrinë e Drejtësisë për këtë qëllim, pa përmendur rezultate konkrete se kur do të përfundojë së miratuar ky urdhër.

Masat mbrojtëse

Një objektiv i inspektimit, ishte verifikimi i funksionimit të sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve për trajtimin e korrespondencave të tyre brenda institucionit dhe me institucionet e tjera qëndrore.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, intervistat e zhvilluara me të burgosurit, si dhe kontrolli i regjistrave, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte sipas kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve⁵.

Në urdhër përcaktohej se, specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore ishin personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike merrnin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve. Në vijim, ata kryenin regjistrimin e tyre në regjistrin përkatës që mbahej në sektorin e protokoll-arshivës së institucionit dhe i dërgonin ato te drejtori i institucionit. Specialistët sipas sektorëve, në varësi të shënimeve të drejtuesit të institucionit, kryenin trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e institucionit⁶.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për vitin 2022 ishin regjistruar rreth 3700 kërkesa nga të burgosurit, të cilat kishin për objekt kërkesa për blerje TV, biseda në SKYPE me familjen, aplikim për hapje llogarie në bankë, kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku, dërgimin te mjekët specialist në Spitalin Rajonal Shkodër, mungesë të medikamenteve mjeksore, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike, etj.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa në lidhje me procedurat që ndiqen nga stafi i institucionit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre nga drejtuesit e institucionit. Ata ngrinin problemin e vonesave në përgjigje të kërkesave të tyre nga DPB, kryesisht për ato kërkesa që kishin të bënin me transferimin në IEVP-të e tjera.

Gjatë inspektimit u verifikuan gjithashtu procedurat e ndjekura për hyrjet e reja të të burgosurve në institucion, ngritja dhe funksionimi i komisionit të pritjes, intervistimi i të

⁵ Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020, “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”.

⁶Neni 58 i ligjit Nr.81/2020, “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”.

burgosurve, evidentimi i gjendjes shëndetësore dhe psiko-sociale të tyre, si dhe mënyrën e plotësimit të regjistrit dhe dosjeve personale të të burgosurve. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga komisioni i pritjes, praktikë kjo e cila ishte e evidentuar në libër dhe në regjistrin përkatës. Më tej, dokumentacioni protokollohet në sekretarinë e institucionit.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Mbulimi me kamera në IEVP Reç, kryhet nga 468 kamera të cilat monitoronin ambientet në regjimin e brendshëm, si dhe mjediset e jashtme të institucionit përgjatë 24 orëve. Të dhënat nga regjistrimet e kamerave ruhen në server për një periudhë 30 ditore.

Mbikqyrja me kamera e ambienteve në regjimin e brendshëm të IEVP-ve, përveç mjedisëve ku çënohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një masë mbrojtëse ndaj personave të privuar nga liria për tre arsye:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjeshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgje dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Të burgosurit komunikonin me telefon me familjet e tyre 2 herë në javë, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, nëpërmjet telefonave me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm.

Në lidhje me telefonatat, të burgosurit paraqitën ankesa në lidhje me shtimin e operatorëve të tjerë me telekartë, pasi monopoli i këtij shërbimi në sistemin e burgjeve, ka sjellë për pasojë rritjen e çmimit të kartave telefonike dhe uljen e minuatave të bisedave telefonike. Ky shqetësim është ngritur nga të burgosurit edhe në IEVP-të e tjera.

Gjithashtu, grupi i inspektimit mori ankesa nga të burgosurit dhe bëri verifikimet përkatëse, në lidhje me komunikimin me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit. Të burgosurit deklarorin se, nuk mund të lidhen me numrat e telefonit të Avokatit të Popullit të vëna në dispozicion të tyre, në çdo kohë dhe pa pagesë, pasi kompania që ofronte këtë shërbim nuk kishte bërë regjistrimin e numrave.

Sjellim në vëmendje të DPB-së, se këto problematika janë konstatuar nga grupet e MKPT-së edhe në IEVP-të e tjera, për të cilat është rekomanduar shtimi i operatorëve telefonik

në sistemin e burgjeve, si dhe heqja e kufizimeve për të komunikuar me numrat e kontaktit të Avokatit të Popullit. Por, sikurse konstatohet edhe nga inspektimi në këtë IEVP, këto rekomandime ende nuk kanë gjetur zbatim.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në IEVP Reç, kishte 7 poste për takime online nëpërmjet kompjuterave, 20 poste për takime fizike me familjarët, 2 dhoma prindërimi në distancë dhe 8 dhoma për takime speciale për të burgosurit familjarë. Nga intervistat, rezultoi se të burgosurit zhvillonin 3 takime fizike dhe 1 takim online me familjarët e tyre⁷.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa për zhvillimin e takimeve, por ata propozonin që me kërkesë të arsyetuar nga të burgosurit, takimi fizik të zëvendësohej me takime online me familjarët, brenda numrit të përgjithshëm të takimeve mujore, duke mos i kufizuar vetëm me një takim online. Takimet me familjarët janë të rregulluara sipas Rregullores së Përgjithëshme të Burgjeve miratuar me VKM dt 06.04.2022.⁸.

Dhomat e prindërimit në distancë, ishin të pajisur me orëditë e nevojshme si tavolinë dhe karrige, nga ku të burgosurit mundet të takoheshin fizikisht fëmijët e tyre. Gjatë takimeve të të burgosurve me fëmijët dhe familjarët e tyre, në këto ambiente respektoheshin masat e sigurisë, si dhe privacia e takimit. Të burgosurit paraqitën kërkesa që në këto dhoma, të zhvillohen edhe takimet fizike me prindërit që janë në moshë të madhe. Nga drejtuesit e institucionit, u informuam se këto propozime të të burgosurve, janë marrë në konsideratë dhe janë parashikuar në draftin e rregullores të brendshme të IEVP Reç, e cila pritet të miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Kushtet materiale

IEVP Reç është një institucion i ri, me infrastrukturë të plotë dhe funksionale në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm të tij, i ndërtuar sipas standardeve të përcaktuara në dispozitat ligjore dhe aktet ndërkombëtare, që parashikojnë normat dhe parametrat teknikë për ndërtimin e këtyre institucioneve.

Kushtet materiale të institucionit në funksion të të burgosurve, në përgjithësi ishin të plotësuar dhe garantonin standardet të mira për jetesë normale dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv, për rehabilitimin e kësaj kategorie.

Gjendja e godinave, ambientet e ajrimit, ambientet e përbashkëta dhe parametrat teknik të ndërtimit të dhomave të banimit, ishin në gjendje të mirë dhe plotësonin kërkesat e të burgosurve. Infrastruktura në regjimin e brendshëm përbëhej nga 5 godina, një për të paraburgosurit dhe 3 godina për të dënuarit, me ambiente të përbashkëta dhe ajrimi më vete për secilën kategori të burgosurish.

⁷Aktualisht takimet me familjarët në të gjitha burgjet e vendit zhvillohen 4 here në muaj nga këto 3 takime fizike dhe 1 takim online, në bazë të Rregullores së Përgjithëshme të Burgjeve miratuar me VKM nr.209, dt.06.04.2022.

Ambientet në cdo sektor në regjimin e brendshëm, ishin sipas standardeve përsa i përket llojshmërisë të aktiviteteve ditore si klasa edukimi dhe për këshillimin psiko-social, dhoma për takimet me familjarët, dhomat e prindërimit në distancë, klasat ku zhvillohej mësimi dhe për zhvillimin e kurseve profesionale, biblioteka, si dhe ambiente kulturi të ndara më vete për besimtarët myslyman dhe katolik. Veç këtyre ambienteve, grupi i inspektimit konstatoi dhe disa ambiente (dhoma) të tjera, të cilat ishin të mbyllura dhe pa funksione. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ato ambiente janë të ndëruara që nga zbatimi i projektit, por nuk përdoren pasi nëse ato vihen në funksion, kërkojnë stafe mbështetëse dhe staf sigurie shtesë nga struktura organike e miratuar.

Dhomat e banimit në secilin sektorë ishin të ndara në dhoma teke dhe dhoma dyshe, me parametra të tillë që mundësonin akomodimin e të burgosurve për jetesë normale. Hapsira dhe sipërfaqja e dhomave ishte sipas normave të lejueshme (kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur)⁹, ndërkohë që dritaret lejonin ajrim dhe dritë të plotë natyrale. Çdo dhomë kishte tualetin e saj, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient dushi të përbashkët për çdo sektor.

Ambientet në regjimin e brendshëm kishin energji elektrike të pandërprerë që furnizohej nga rrjeti elektrik, të nevojshme për ndriçim dhe për nevoja të higjienës personale. Institucioni kishte dhe burim energjie rezervë me gjeneratorë, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerje.

Në hollin e korridoreve të sektorëve kishte ambiente të përbashkëta me tavolina dhe karrige ku zhvilloheshin lojëra tavoline si shah, domino dhe lojëra me letra. Çdo sektor kishte telefona me kartë që të burgosurit mund të komunikonin me familjet e tyre, si dhe kuti postare për hedhjen e kërkesë/ankesave, të cilat hapeshin nga personeli i autorizuar i institucionit për këtë qëllim.

Furnizimi me ujë kryhej nga rrjeti i ujësjellësit të Malësisë së Madhe, përmes një linje të dedikuar për këtë institucion. Ambientet në regjimin e brendshëm furnizoheshin me ujë sipas orareve të miratuar nga titullari i institucionit, 3 herë në ditë. Grupi i inspektimit të MKPT-së, mori shumë ankesa nga të burgosurit për mungesën e furnizimit rregullisht me ujë që përdorej për mbajtjen e higjienës personale, për larjen e trupit dhe pastërtinë në ambientet e përbashkëta, pasi orari i furnizimit ishte i reduktuar dhe nuk arrinte të plotësonte nevojat e tyre. Përsa i takonte sigurimit të ujit të pijshëm, të burgosurit deklarorin se atë e blinin kundrejt pagesës në njësinë e re tregtare, gjë e cila rriste shpenzimet e familjarëve të tyre.

Trajtimi me ushqim për të dënuarit dhe të paraburgosurit kryhej rregullisht me 3 vakte dhe i ndarë sipas kategorive për të burgosurit, për të sëmurët me diabet dhe për të punësuarit. Ushqimi gatuhej në kuzhinën e institucionit, e cila ishte me hapsirë e sipërfaqe të madhe, si dhe me ambiente më vehte për gatimin e ushqimit dhe për ruajtjen e ushqimit. Kuzhina ishte e kompletuar me pajisje frigoriferike për secilin produkt ushqimor më vehte, me pajisje kuzhine alternative (elektrike dhe gaz) për gatimin e vakteve ushqimore, si dhe

⁹ Neni 33/4 i ligjit 81/2020 "Për trajtimin e të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve".

karroca dhe vaska nikelato për shpërndarjen e ushqimit deri te të burgosurit, të cilat ishin të reja dhe e një cilësie shumë të mirë.

Në ambientin e kuzhinës ndodhej e afishuar kuota ditore, menyja, si dhe librezat shëndetësore të personelit guzhiner dhe ndihmës guzhiner. Kampionët e ushqimit për secilin vakt ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike, në një kuti të mbyllur me çelës dhe të vulosur nga punonjësi i policisë të informacionit.

Personeli i kuzhinës përbëhej nga 4 guzhiner sipas strukturës organike dhe 10 ndihmës guzhiner dhe shpërndarës ushqimi të punësuar nga të dënuarit/paraburgosurit. Në intervistat me të dënuarit dhe të paraburgosurit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit, por ata kishin pretendime për larmishmërinë e tij. Larmishmëria është si rezultat i normave të ulta të ushqimit ditor, të përcaktuara në urdhërin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.¹⁰

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktiviteti i të burgosurve, ishte i përcaktuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga titullari i këtij institucioni. Orari i veprimtarive ishte i miratuar nga drejtori i institucionit dhe i unifikuar për të gjithë sektorët, pavarësisht sigurisë të të burgosurve dhe aktiviteteve që zhvilloheshin sipas grup moshave dhe kategorive, si për të dënuarit edhe për të paraburgosurit.

Sektori për çështjet shoqërore, ishte sektori përgjegjës bashkë me punonjësit e sigurisë, për zbatimin e orarit sipas programit ditor dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve. Struktura organike e këtij sektori përbëhej nga 7 punonjës, 1 shef sektori dhe 6 punonjës me profesion psikolog dhe punonjës social. Organika e këtij sektori nuk ishte e plotësuar ende me 1 psikolog dhe 1 punonjës social.

Nga ana dokumentare, sektori i çështjeve shoqërore kishte të hartuar programe mujore pune, programe për trajtimet individuale psiko-sociale, si dhe dhe plane mujore të aktiviteteve. Në rastin e festave kombëtare dhe festave fetare, në bashkëpunim me sektorin e policisë, ishin organizuar aktivitete të veçanta. Për secilin të dënuar dhe të paraburgosur ishin të plotësuara dosjet psiko-sociale.

Grupi i inspektimit, zhvilloi intervista me të burgosurit dhe mori informacion në lidhje me llojshmërinë e aktiviteteve. Të burgosurit deklarorin se të vetmet aktivitete që organizoheshin në institucion ishin lojrat e tavolinës, kalçeto dhe aktivitetet fetare, ndaj ata ngritën ankesa për mungesën e llojshmërisë së aktiviteteve kulturore dhe sportive, që paraqisnin interes për të burgosurit, si dhe për mungesën e kontakteve të përditshme të stafit psiko-social me të burgosurit, me qëllim dhënien e asistencës në lidhje me problematikat që ata i shqetësonin.

¹⁰ Urdhër i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.205/3 prot., datë 27.07.2006 "Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit".

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve me të burgosurit, legjislacioni në fuqi dhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikojnë që aktivitetet duhet të jenë të alternuara, të shumëllojshme dhe që të ngjallin interes për këtë kategori, duke theksuar se: *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*¹¹.

Mekanizmi Kombëtar thekson nevojën e menjëhershme të ndërthurjes së aktiviteteve kulturore-sportive dhe edukative me të burgosurit sipas grup moshave dhe kategorive, si dhe hartimin e programeve për këshillimin dhe trajtimin individual të këtyre personave, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet te këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.

Nga informacioni me drejtorin e institucionit, grupi i inspektimit u informua se, Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet DPB-së dhe Shoqatës “Pro-Eksport Albania” lidhur në 25 Janar 2021, për krijimin e mundësive për punësimin e personave të burgosur, ishte në proces implementimi. Grupi i inspektimit verifikoi ambientet dhe kushtet e punës, kryesisht në punimet e drurit dhe të kashtës, ku u gjetën 2 grupe me 20 persona të punësuar në këtë sektor. Këto punime tregtoheshin, duke siguruar të ardhura financiare për të burgosurit e vetëpunësuar.

Organika e miratuar për punësuarit, kishte 48 vetë, kryesisht të punësuar në sektorë si kuzhina, sanitar, lulishtar, lavanderi, bibliotek etj. Me të burgosurit e punësuar, ishin lidhur kontratat e punës me institucionin dhe pagesat financiare do të fillonin nga muaji Qershor 2022, pasi të përfundonin hapjen e numrave të llogarive në bankat e nivelit të dytë. Të punësuarit ngritën si problematikë faktin se, për periudhën nga muaji Tetor 2021, koha kur është miratuar VKM, deri në muajin Qershor 2022, **të punësuarit nuk kanë përfituar asnjë asnjë lloj shpërblimi**, as ulje për ditët e dënimit dhe as shpërblim financiar. Ky shqetësim është ngritur nga të punësuarit jo vetëm në IEVP Reç, por edhe në institucionet e tjera të burgjeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, rekomandon DPB-së që efektet financiare për shpërblimin e të burgosurve për punën e kryer, duhet të fillojnë nga data 1 Janar 2022, afati që parashikohet në VKM për këtë qëllim, pavarësisht se kontratat e punës ndërmjet institucionit dhe të punësuarve janë lidhur në muajin Qershor 2022. Dispozitat e parashikuara në Kodin e Punës, zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, sikurse është rasti i të burgosurve të punësuar. Në kuptim të ligjit, kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Ndërsa

¹¹Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDS/ETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>.

e drejta për shpërblim financiar për këtë kategori, ka lindur nga momenti (koha) që ata kanë shprehur vullnetin dhe kanë pranuar të kryejnë atë lloj pune që ka ofruar institucioni.

Shërbimi Shëndetësor

Referuar statistikave të raportuara nga sektori shëndetësor, në IEVP Reç ndodheshin 62 të sëmurë kronikë, 23 të sëmurë me probleme kardiologjike, 17 të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, 20 të sëmurë me probleme stomatologjike, 9 persona që trajtohen me metadon, etj. Trajtimi mjekësor i tyre kryhej sipas protokolleve shëndetësore të rekomanduara nga mjekët specialistë, duke përfshirë edhe kryerjen e vizitave periodike pranë Spitalit Rajonal Shkodër ose QSUT-së në Tiranë.

Sektori shëndetësor, kishte në organikë 15 punonjës, nga të cilët 2 mjekë të përgjithshëm, 1 stomatolog, 1 farmacist dhe 11 infermier. Referuar strukturës organike, institucioni kishte 2 mungesa në pozicionin e mjekut të përgjithshëm. Ndërkohë, një mjek punonte me kontratë me kohë të pjesshme të lidhur me institucionin dhe kryente vizita mjekësore sipas orareve të përcaktuara në kontratë 4(katër) orë çdo ditë, ndërsa në rastet urgjente paraqitej menjëherë në institucion.

Sipas informacionit, organika e sektorit shëndetësor ishte plotësuar gjatë vitit 2022 me 1(një) farmacist dhe 2(dy) infermier, të cilët pritej të fillonin së shpejti në detyrat e tyre. Pavarësisht kësaj, në intervistat e zhvilluara me të dënuarit dhe të paraburgosurit, ata paraqitën ankesa të shumta në lidhje me mungesën e mjekut me kohë të plotë, si dhe për kryerjen me vonesë të vizitave mjekësore apo dhe lëshimin e rekomandimeve për kryerjen e vizitave pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Shkodër.

IEVP Reç kishte dy ambiente për ofrimin e shërbimit shëndetësor, ambientin e spitalit dhe ambientin e seksionit të kujdesit të veçantë (SKV). Në dhomat e spitalit ishin të shtruar pacinetë për raste të urgjencave dhe të sëmurët kronikë, ndërsa në seksionin e kujdesit të vecantë (SKV) trajtoheshin të sëmurë me probleme të shëndetit mendor. Në funksion të shërbimit shëndetësor, institucioni kishte në dispozicion edhe një mjet ambulancë, për të përballuar rastet e urgjencave dhe shoqërimin e tyre për në spitalin rajonal në Shkodër.

Ambienti i spitalit kishte 11 dhoma, me dy krevatë në secilën dhomë. Në momentin e inspektimit ndodheshin të shtruar 6(gjashtë) të sëmurë kronikë sipas rekomandimit të mjekut të institucionit. Në këtë ambient ndodhej dhoma e mjekut e kompletuar me të gjitha orëditë dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe rafti për mbajtjen e kartelave shëndetësore për secilin të burgosur; dhoma e stomatologut e pajisur me kabientin e ri për kryerjen e vizitave dhe mbushjen e dhëmbëve; dhoma e farmacistit ku mbaheshin ilaçet dhe regjistri për hyrjet dhe shpërndarjen e medikamenteve sipas rekomandimit të mjekut të institucionit; dhoma e terapisë, si dhe ambientet e përbashkëta si tualete dhe dushe për larjen e trupit të pacientëve.

SKV kishte 18 dhoma me 18 shtretër dhe në momentin e inspektimit ndodheshin të shtruar 9 të sëmurë të burgosur, që trajtoheshin me probleme të shëndetit mendor. SKV kishte edhe ambiente të përbashkëta për ajrimin, tualete dhe dushe për larjen e trupit.

Skema e rimbursimit të ilaçeve, funksiononte sipas kontratës tre palëshe të lidhur mes FDSKSH-së, depos farmaceutike dhe institucionit, e cila i referohej historikut të sëmundjeve për çdo të dënuar dhe të paraburgosur, të plotësuar nga mjeku i institucionit në kartelat personale të tyre. Gjithashtu, furnizimi me ilaçe i institucionit kryhej periodikisht nga sektori i shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe nëpërmjet blerjeve të drejtëpërdrejtë me fondet e akorduara në buxhetin e institucionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson kushtet infrastrukturore të krijuara për ofrimin e shërbimit shëndetësor të të burgosurve, por thekson se, mungesa e mjekut me kohë të plotë dhe mosfunksionimi i këtij shërbimi për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave dhe nevoja të të sëmurëve në këtë institucion, shkakton në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur.

Lidhur me këtë konstatim, KPT (CPT) në rolin e monitoruesit ndërkombëtarë të respektimit të drejtave të të burgosurve, ka rekomanduar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Në këtë kuadër, vlen të theksohet edhe përcaktimet në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹².

Nga kqyrja e dokumentacionit të shërbimit shëndetësor u evidentua se, në dhomën e mjekut ndodheshin regjistri i vizitave mjekësore, kartelat mjekësore të të burgosurve, si dhe regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike dhe formatet e kontrollit mjekësor sipas Protokollit të Stambollit¹³, të cilat ishin të sekretuara, të plotësuar sipas rubrikave dhe mbaheshin në dollap të mbyllura me çelës.

Ndërsa në dhomën e infermierisë, ndodhej regjistri i informacionit 24 orësh që mbahej nga personeli i infermierëve, si dhe regjistri për shpërndarjen e medikamenteve të sëmurëve të burgosur në bazë të rekomandimit të mjekut, të cilat ishin të sekretuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata*

¹² Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

¹³ <https://www.ohchr.org/EN/pages/home.aspx>

<http://www.phrtoolkits.org/toolkits/istanbul--protocol--model--medical>

publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:
b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”.

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masat e menjëhershme, për plotësimin e vendeve vakante në sektorin e shëndetësisë të IEVP Reç me 2 mjekë të përgjithshëm, të punësuar me kohë të plotë, ose 3 mjekë me kohë të pjesëshme, me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor për të burgosurit, sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe protokolleve shëndetësore, për secilën kategori të të sëmurëve.
2. Të shpejtohen procedurat për zbatimin në kohë sa më të shpejtë të projektit për vënien në funksionim të sistemit qendror për ngrohje/ftohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm të institucionit,.
3. Të gjenden mundësi alternative nga ana e institucionit, për furnizimin me ujë të rrjedhshëm dhe ujë të ngrohtë të ambienteve në regjimin e brendshëm, për mbajtjen e higjienës personale të të burgosurve, larjen e trupit dhe pastërtinë e ambienteve të përbashkëta.
4. Të merren masa të menjëhershme, për plotësimin e organikës të sektorit të çështjeve shoqërore me 2 punonjës psikolog/punë sociale, riorganizimin dhe vënien në efikasitet të punës të këtij sektori, me qëllim shtimin e kontakteve të stafit me të burgosurit, si dhe në hartimin e programeve për rehabilitimin, këshillimin, ri-integrimin e të burgosurve dhe në organizimin e aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive me të burgosurit.
5. Të merren masa të menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante në stafin e punonjësve të policisë (94 PRB), sipas funksioneve në strukturën organike.
6. Të merren masa për vënien në funksion të ambientit të palestrës që ndodhet në regjimin e brendshëm të institucionit, plotësimin e saj me bazën e nevojshme materiale, si dhe miratimin e një grafiku për shfrytëzimin e saj gjatë kohës së lirë nga të burgosurit
7. Të merren masa të menjëhershme, për plotësimin e kërkesave të të burgosurve për kryerjen e bisedave telefonike me familjarët e tyre, hapjen e linjës pa shpërbllim për numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit dhe komunikimin e të burgosurve në lidhje me adresimin e ankesave. Të merren masa administrative disiplinore për punonjësit që nuk kanë garantuar këtë të drejtë ligjore të të burgosurve.

8. Marrjen e masave për zbatimin e VKM-së për pagesën e të dënuarve që punojnë, për periudhën Janar-Qershor 2022.
9. Të shihet mundësia e më shumë se një takimi online për të burgosurit, referuar Rregullores së Pergjithëshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr.209, dt.06.04.2022.
10. Të merren masa të menjëhershme, për plotësimin e nevojave jetike të të paraburgosurve që mbahen përkohësisht në ambientet e tranzitit në IEVP Shënkoll (për shkak të proceseve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë), duke ju siguruar atyre trajtim njerëzor dhe me dinjitet. DPB-ja të shkurtojë kohën e qëndrimit të të paraburgosurve në ambientet e tranzitit që ndodhen në disa nga IEVP-të, duke i transportuar sa më parë (me përfundimin e seancave gjyqësore), për në vendet e vuajtjes së dënimit.
11. Të merren masa nga sektori shëndetësor, për koordinimin e punës me spitalin Rajonal Shkodër, me qëllim dhënien në kohë të përgjigjeve të analizave të të burgosurve të sëmurë në këtë institucion.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI